

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“AUTO VOLS”

Në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare e Biznesit” dhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin tonë të lirë, të shprehur në nënshkrimin e Aktit Themelues :

Unë Erlis Bako, i biri i Qemalit, dtl 25.06.1983, banues ne Rr Xhanfize Keko ,pll Invest ap 18 ,Tirane

Dhe

Unë Luan Mlika, i biri i Bajramit, dtl 02.04.1976, banues ne Rr. Zihni Sako Kompleksi Kolombo 2 G/2 K4 Ap 25 Tirane

Sot më datë 14.07.2021, hartojme Statutin e shoqërisë si më poshtë :

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqëria emërtohet “AUTO VOLS_” sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqërise tregtare private “AUTO VOLS ” sh.p.k. do të jetë :
Njesia bashkiake Nr 7, Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati nr 22, Njesia nr 8, Tirane

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

NENI 3



Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar mbi 15 vjet. Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga moment i regjistrimit në Qendrën Kombëtare e Biznesit.

NENI 4

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

1. Autoshkollë duke përfshirë të gjitha llojet e shërbimit të kësaj fushe.

2. Dhenie me qera të autovegurave, motorrave dhe mjeteve të tjera.

3. Tregtimin me shumicë e pakicë dhe import-eksport të atovegurave

Mallra industriale, lëndë të para, pjesë këmbimi për makina, hidro – sanitare, hidraulike, kanceleri për zyra e shkolla, orendi shtëpiake, mobilje të ndryshme, pajisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro – shtëpiake, kompiuterike, pjesë këmbimi për automjete.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “AUTO VOLS” sh.p.k. do të jetë **2.000.000** (nje milion) lekë. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali përbëhet nga **2** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **1.000 000** lekë.

Z. Erlis Bako zotron 1 kuote me vlerë 1.000 000 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar

Z. Luan Mlika zotron 1 kuote me vlerë 1.000 000 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar

NENI 6


Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themeltar fillestar, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme etj, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 7

Kuota e kapitalit themeltar fillestar sigurohet nga ortakut themelues dhe është i regjistruar në librin e llogarise të shoqërisë.

NENI 8

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen më nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojnë ortakut themelues, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.



NENI 9

Shoqëria tregtare "AUTO VOLS" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale dhe jo-materiale, duke përfshirë dhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet tek të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria tregtare "AUTO VOLS" sh.p.k. gëzon të drejta, sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Shoqëria tregtare "AUTO VOLS" sh.p.k. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaket themelues të shoqërisë mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Erlis Bako i cili është edhe përfaqësues ligjor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 12

Hyjnë brenda detyrave dhe kompetencave të ortakut themelues si më poshtë:

1. Nryshimi i aktit të themelimit dhe i statutit të shoqërisë.
2. Ndryshimi i selisë së shoqërisë dhe hapja e selive të reja.
3. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve të administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarisë vjetore.
4. Zgjedhja e administratorëve jo-ortakë dhe caktimi i detyrave dhe i kompetencave të tyre, me përjashtim të atyre që shënohen në statut.
5. Aprovimi i garancive që ka shoqëria.
6. Miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria.
7. Pranimet në punë dhe largimet nga puna.
8. Caktimi i formës së vulës dalluese të shoqërisë.

NENI 13

Administratori jo ortak përveç detyrave që i cakton ortaku themelues i shoqërisë ka edhe këto detyra e të drejta :

1. Të mirë-administrojë pasurinë e shoqërisë.

2. Të bëjë marreveshje me të tretet brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kopetencave të caktuara nga ortakut themelues.
3. Të zbatojë rregulloren e brendshme të shoqërisë.
4. Të përgjigjet për dëmet që i sjell Shoqërisë nga veprimet e tij.
5. Të paguhet për punën që kryen në bazë të marreveshjes të bërë me ortakun themelues.
6. Të marre te dhëna dhe të bëjë propozime për gjithçka që e çmon si të dobishme për shoqërinë.
7. Të kryejë të gjitha veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë e shoqërisë.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 14

Shoqëria ka të drejtë :

1. Të kryej veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë.
2. Të sigurojë pasurinë e vet.
3. Të marre kredi në lekë dhe në valutë nga bankat vendase dhe të huaja në bazë të rregullave ligjore.
4. Të përfitojë nga favorët që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera.
5. Të investojë kudo në Shqipëri, nga të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.
6. Të punësojë punonjës të thjeshtë ose të kualifikuar, vendas ose të huaj.
7. Të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 15

Shoqëria ka për detyrë:

1. Të sigurojë kapitalin themeltar në formën dhe kohën e duhur.
2. Të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria.
3. Të sigurojë punonjësit e saj.
4. Të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Të respektojë standartet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 16



E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të verimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

NENI 17

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci.

NENI 18

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

NENI 19

Shoqëria mban xhiro-llogaritë në Bankë. Llogaritë mbahen në lekë dhe pasqyrohen në librat përkatëse.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, shoqëria, pasi bën zbritjet e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5 % të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", deri sa ky fond të arrijë në masën 10 % të kapitalit themeltar.

NENI 21

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendura më sipër dhe pagimit të detyrimeve fiskale, i mbesin në përdorim ortakut themelues të shoqërisë.

Konvertimi i parasë të realizuar nga shitja do të bëhet sipas kushteve që do të ketë Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do të bëhet në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË VECANTA

NENI 22

Shoqëria ka vulën e vet dalluese.

SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 23

Shndërrimi i shoqërisë "AUTO VOLLS" sh.p.k. në shoqëri aksionere, mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve



Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

Shoqëritë mund të riorganizohen vetëm pasi kanë qënë të regjistruara për të paktën një vit. Bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

NENI 24

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, si:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
- Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- Pamundësi veprimi.
- Me vendim të asamblesë së ortakëve.

Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare e Biznesit",

Në këto raste, pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Likuidatori është përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë përderisa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizik e juridik, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria.

Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakut themelues të shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që i takojnë atij.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut, referohen plotësimet që do të bëhen nga ortaku themelues, si edhe ligjeve të veçanta të legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotësimet e këtij statuti bëhen me mënyrën dhe procedurën me të cilën nxirret vetë statuti.

NENI 26

Ky Statut përpilohet në dy kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare e Biznesit, tjetra mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "AUTO VOLS" sh.p.k.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"AUTO VOLS" sh.p.k.

ERLIS BAKO

LUAN MLIKA

Erlis Bako

Luan Mlika

